



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 8, Datë 07.03.2014

PËR

MIRATIMIN E LEJES ZHVILLIMORE KOMPLEKSE PËR RESORTIN TURISTIK
“GREEN COAST”, PALASË, BASHKIA HIMARË

Në mbështetje të neneve 70/8 dhe 70/11 të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM-së nr. 502, datë 13.07.2011 “Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, dhe VKM-së nr. 877, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për resortin turistik “Green Coast”, Palasë, Bashkia Himarë, me zhvillues “Green Coast” Sh.p.k.
2. Të bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi:
 - a. Dokumenti i Rregullores së Lejes Zhvillimore Komplekse;
 - b. Harta e planit të zhvillimit dhe zonimit të parcelave;
 - c. Harta e planit të vendosjes së infrastrukturës rrugore të propozuar.
3. Formulari i Lejes Zhvillimore Komplekse i jepet kërkuesit vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Njesisë Vendore.
4. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

Znj. EGLANTINA GJERMENTI



MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT



SEKRETARE E KKT

Znj. ADELINA GRECA



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

